



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**



# STRATEGJIA KUNDËR KORRUPSIONIT

2021 - 2023

## Përmbajtja

I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	4
II.	HYRJE .....	5
III.	METODOLOGJIA: .....	6
IV.	HISTORIKU: .....	7
V.	SITUATA AKTUALE .....	8
1.	Korniza ligjore.....	10
VI.	OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME TË STRATEGJISË .....	11
1.	Parimet e përgjithshme të Strategjisë:.....	11
VII.	AKTIVITETET DHE ALTERNATIVAT E KONSIDERUARA .....	13
1.	Sektori politik .....	13
2.	Administrata Publike.....	16
3.	Zbatimi i ligjit dhe gjyqësorit .....	17
4.	Prokurimi Publik dhe Menaxhimi i Financave Publike.....	19
VIII.	SFIDAT PËR ARRITJEN E OBJEKTIVAVE STRATEGJIKE .....	21
IX.	QASJA E REKOMANDUAR.....	22
X.	ZBATIMI, MONITORIMI DHE VLERËSIMI I STRATEGJISË.....	23
1.	Roli i sistemit të monitorimit .....	23
2.	Kapacitetet institucionale për monitorim dhe vlerësim .....	23
3.	Shpërndarja dhe përdorimi i rezultateve të monitorimit dhe vlerësimit .....	24
XI.	PLANI I VEPRIMIT .....	25
XII.	PRIORITETET DHE PËRGJEGJËSITË.....	26

**I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**

*Lista e institucioneve, pjesëmarrës në Grupin Punues për hartimin e Strategjisë.*

- 1 Agjencia Kundër Korrupsionit
- 2 Ministria e Drejtësisë
- 3 Ministria e Punëve të Brendshme
- 4 Kuvendi i Kosovës
- 5 Ministria e Pushtetit Lokal
- 6 Policia e Kosovës
- 7 Zyra e Kryeministrit
- 8 Zyra Kombëtare e Auditimit
- 9 Doganat e Kosovës
- 10 Inspektorati Policor i Kosovës
- 11 Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
- 12 Organi Shqyrtues i Prokurimit
- 13 Ministria e Financave
- 14 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
- 15 Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
- 16 Këshilli Gjyqësor i Kosovës
- 17 Agjencia Kosovare e Privatizimit
- 18 Ministria e Mbrojtjes
- 19 Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
- 20 Këshilli Prokurorial i Kosovës
- 21 Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike
- 22 Administrata Tatimore e Kosovës
- 23 Ministria e Arsimit dhe Shkencës
- 24 Ministria e Shëndetësisë
- 28 Lëvizja FOL

**SHKURTESAT:**

AKK	Agjencia Kundër Korrupsionit
ZKM	Zyra e Kryeministrit të Kosovës
MPL	Ministria e Pushtetit Lokal
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MASH	Ministria e Arsimit dhe Shkencës
MF	Ministria Financave
MK	Ministria e Kulturës
MD	Ministria e Drejtësisë
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MSH	Ministria e Shëndetësisë
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
PSH	Prokurori i Shtetit
KPK	Këshilli Prokurorial i Kosovës
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
PK	Policia e Kosovës
IPK	Inspektorati Policor i Kosovës
KRPP	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
ZAP	Zyra e Auditorit të Përgjithshëm
OSHP	Organi Shqyrtues i Prokurimit
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
AKP	Agjencia Kosovare e Privatizimit

## I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Korrupsioni vazhdon të jetë sfidë e Institucioneve dhe shoqërisë në Kosovë. Perceptimi i përgjithshëm i shoqërisë mbi korrupsionin është akoma i lartë. Andaj, kërkohet që të forcohen më tutje mekanizmat vendor për luftimin dhe parandalimin e korrupsionit. Përmirësimi i politikave dhe zbatimi më efektiv i tyre dhe mirëqeverisja mbetet si dy nga kushtet kryesore për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit, në mënyrë që të kemi sundim të ligjit në Kosovë.

Agjencia kundër Korrupsion ndër vite ka punuar në hartimin e kësaj strategjie. Ndërkaq, gjatë vitit 2020 në procesin e hartimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit kundër Korrupsion 2021 – 2023, ka ndikuar edhe situata me pandeminë (COVID19) me të cilën po sfidohet shoqëria dhe shteti.

Kjo Strategji dhe Plan i Veprimit do të jetë e vlefshëm deri në aprovimin e Ligjit relevant për Agjencinë Kundër Korrupsion – Ligji për Parandalimin e Korrupsion i cili është në proces e sipër. Kjo pasi që sipas draftit aktual të këtij ligji përcaktohet se Strategjinë dhe Planin e Veprimit kundër Korrupsion do të hartohet nga Zyra e Kryeministrit, ndërsa Agjencia kundër Korrupsion do të jetë monitoruese e aktiviteteve që rrjedhin nga Plani i Veprimit.

Gjatë hartimit të Strategjisë Kundër Korrupsionit 2021 – 2023 dhe Planit të Veprimit, janë marrë për bazë të gjitha raportet e ndryshme vendore dhe ndërkombëtare në lidhje me korrupsionin dhe perceptimin mbi korrupsionin në Kosovë. Në këtë kontekst, janë ndarë sektorët primar ndaj të cilëve do të kërkohet llogaridhënie më e madhe dhe transparencë e plotë në kryerjen e detyrave dhe mandatit të institucioneve gjegjëse. Po ashtu, në bazë të problemeve të identifikuar dhe sfidave të paraqitura, janë propozuara masat dhe aktivitetet të cilat në mënyrë sa më efektive kanë paraparë mjetet dhe metodat e parandalimit dhe luftimit të korrupsionit.

Si rezultat i problemeve dhe sfidave të identifikuar dhe në bazë të aktiviteteve dhe masat e përcaktuara për luftimin dhe parandalimin e korrupsionit në Kosovë, Strategjia është ndarë në këto sektorë:

- ⇒ SEKTORI POLITIK
- ⇒ ADMINISTRATA SHETETËRORE DHE QEVERISJA LOKALE
- ⇒ ZBATIMI I LIGJIT DHE GJYQËSORI
- ⇒ PROKURIMI PUBLIK DHE MENAXHIMI I FINANCAVE PUBLIKE

Zhvillimi i qasjes “zero tolerancë” ndaj korrupsionit vazhdon të jetë ndër objektivat kryesore të strategjisë, e cila ndërlidhet me të gjitha objektivat e përgjithshme dhe specifike të Strategjisë dhe Planit të Veprimit. Ndërkaq parimet tjera të përgjithshme të strategjisë janë: Ndërtimi i integritetit, përgjegjësisë dhe transparencës në punën e organeve të administratës shtetërore dhe forcimin i besimit të qytetarëve në institucionet publike, Përmirësimi i legjislacionit dhe fuqizimi i kapaciteteve institucionale për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit, dhe Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë në fushën kundër-korrupsionit.

## II. HYRJE

Korrupsioni është një nga pengesat kryesore në rrugën e arritjes së zhvillimit të qëndrueshëm politik, ekonomik dhe social të një shteti. Në renditjen globale të indeksit, në lidhje me perceptimin e korrupsionit në vendet e Evropës dhe Ballkanit Perëndimor, sipas Transparency International, Kosova në vitin 2019 është renditur në një pozitë të pafavorshme radhitet e 101-ta me 36 pikë nga gjithsej 180 shtete. Ky rezultat do të thotë se ka shënuar përkeqësim në luftën kundër korrupsionit krahasuar me vitin 2018, kur ka qenë në vendin e 93-të, me 37 pikë. Prandaj, përveç rritjes së transparencës, integritetit, parandalimit dhe luftimit të korrupsionit, është edhe në interes të Kosovës që ndikoj në përmirësimin e perceptimit të korrupsionit.

Parandalimi dhe luftimi i korrupsionit është një detyrim i përcaktuar në legjislacionin që rregullon deklarin e pasurisë, konfliktin e interesit, mbrojtjen e sinjalizuesve dhe fushat e tjera që lidhen me fushë-veprimtarinë e AKK-së dhe institucioneve të tjera të zbatimit të ligjit, por, njëkohësisht është edhe obligim i cili rrjedh nga anëtarësimi i Kosovës në organizatat ndërkombëtare për luftën kundër korrupsionit, siç janë Konventat e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit, Konventa Penale kundër Korrupsionit e Këshillit të Evropës, Konventa Civile e kundër Korrupsionit Këshillit të Evropës dhe standarde të tjera kundër korrupsionit.

Përkundër përparimit të arritur deri më tani, Kosova si vendet e tjera në rajon, vazhdon të përballet me vështirësi në sektorin e Sundimit të Ligjit, respektivisht me mangësitë në sistemin gjyqësor, çështjet e brendshme dhe qasjen në drejtësi. Raportet e ndryshme ndërkombëtare, duke përfshirë Dokumentet Teknike të Projekteve të ndryshme siç janë Projekti Kundër Krimin Ekonomik – PECK II dhe Projekti Përkrahja e Përpjekjeve Kundër Korrupsion – SAEK II, si dhe Raportet e Progresit për Kosovën nga Komisioni Evropian dhe dokumentet strategjike kombëtare nxjerrin në pah nevojën për angazhim proaktiv të shtetit në përmirësimin e efikasitetit të policisë, prokurorisë dhe gjyqësorit në përgjithësi, veçanërisht në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit dhe krimin të organizuar.

Bazuar në të dhënat e Raportit Vjetor të Punës AKK për vitin 2019, vërehet se përpjekjet e përbashkëta të sistemit të drejtësisë dhe mekanizmave të tjerë janë të nevojshëm për të luftuar korrupsionin në mënyrë që të ndërtohet një sistem i fortë institucional që prodhon rezultate konkrete në luftën kundër korrupsionit dhe përfundimisht krijon dhe rrit besimin tek qytetarët. Prandaj, të gjitha institucionet, edhe ato të zbatimit të ligjit, duhet të jenë më të koordinuara dhe sa më efektive në fushat që lidhet me parandalimin, hetimin dhe luftimin e korrupsionit, dhe aspektet tjera në fushën e kundër korrupsionit.

Ndonëse është bërë progres në luftimin e korrupsionit, ajo vazhdon të jetë një shqetësim për Institucionet e Republikës së Kosovës. Me gjithë angazhimet për krijimin e një mjedisi të lirë social nga ndikimi i korrupsionit, rezultatet ende nuk mund të konsiderohen të kënaqshme. Autoritetet e Kosovës kanë përcaktuar përparësi të qarta për zbatimin e legjislacionit që synon luftimin dhe parandalimin e korrupsionit, promovimin e transparencës dhe forcimin e integritetit institucional.

### III. METODOLOGJIA:

Bazuar në Vendimin të Drejtorit të Agjencisë Kundër Korrupsionit, është themeluar Grupi Teknik Punues për zhvillimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit kundër Korrupsionit (2021-2023). Grupi përbëhet nga Institucionet që janë përgjegjëse për luftimin dhe parandalimin e korrupsionit dhe sundimin e ligjit në Kosovë. Grupi punues gjithashtu përfshin përfaqësues të shoqërisë civile. Institucionet e angazhuara në këtë Grup Punues janë nga AKK, ZKM, KGJK, KPK, MPB, KUVENDI I KOSOVES, MPL, PK, KRPP, OSHP, MF, ZAP, KQZ, MTI, MD, MPPH, MASH, MSH dhe Organizata të Shoqërisë civile. Po ashtu janë mbajtur disa takimet sektoriale, takime me pikat e kontaktit, takime me anëtarët e grupit punues si dhe takime me përfaqësuesit e shoqërisë civile.

Anëtarët e grupit teknik kanë dhënë komentet e tyre dhe propozimet në lidhje me aktivitete e planit të veprimit, komentet e tyre janë pranuar dhe diskutuar në takimet e mëvonshme të grupit teknik.

Strategjia dhe plani i veprimit të saj është përgatitur në bazë të dispozitave ligjore të Udhëzimit Administrativ (QRK) nr. 07/2018 për planifikimin dhe hartimin e dokumenteve strategjike dhe planeve të veprimit dhe në bazë të nenit 16 të Ligjit për AKK, nr. 0 /L-159, në bashkëpunim me Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe Institucionet e tjera qeveritare dhe joqeveritare.

Hartimi i Strategjisë Kundër Korrupsionit dhe Planit të Veprimit është obligim i përcaktuar në Ligjin aktual në fuqi me Nr.03/L-159 për Agjencinë Kundër Korrupsion. Neni 5, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.3, i cili përcakton se Agjencia monitoron dhe mbikëqyr zbatimin e Strategjisë Kundër Korrupsionit dhe Planit të Veprimit. Ndërkaq, Neni 16, paragrafi 1 dhe 2, i Ligjit Nr.03/L-159 për Agjencinë Kundër Korrupsion obligon se *Agjencia, në bashkëpunim me Qeverinë dhe institucionet e tjera qeveritare dhe joqeveritare harton Strategjinë kundër Korrupsionit, Agjencia përmes Qeverisë paraqet për miratim Strategjinë kundër Korrupsionit në Kuvendin e Kosovës, dokument i cili përmban politikën kundër korrupsionit që duhet të zbatohet nga institucionet përgjegjëse të Republikës së Kosovës, si në nivel qendror ashtu edhe në atë lokal.* Për më tepër, Neni 17 i ligjit thekson që *në zbatim të Strategjisë kundër Korrupsionit, Agjencia harton Planin e Veprimit kundër Korrupsionit në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse të Republikës së Kosovës, ... .*

Hartimi dhe miratimi i kësaj Strategjie është edhe pjesë e procesit të integritetit të Kosovës në Bashkimin Evropian, është e përcaktuar si Objektivë në Programin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (PKZMSA) 2020 – 2024 të miratuar nga Qeveria më 19 Maj 2020 (Faqe 185 dhe 286 të dokumentit); është pjesë e Agjendës për Reforma Evropiane (ERA); është obligim i përcaktuar në Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit, dhe në të njëjtën kohë Zotim i dhënë nga Qeveria në Samitin e Triestës dhe Samitin e Londrës - si pjesë e Procesit të Berlinit.

#### IV. HISTORIKU:

AKK është organ i pavarur dhe i specializuar për zbatimin e politikave shtetërore për luftimin dhe parandalimin e korrupsionit në Kosovë. Agjencia është themeluar në korrik të vitit 2006, ndërsa është funksionalizuar më 12 shkurt 2007. Mandati dhe kompetencat e Agjencisë janë të përcaktuara në nenin 6 të Ligjit Nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit.

Fushëveprimi i Agjencisë është i përqendruar në hetimet dhe aspektet administrative. Këtë mandat AKK e realizon përmes procesit të deklarimit të pasurisë së zyrtarëve të lartë publik, deklarimit dhe regjistrimit të dhuratave të zyrtarëve publik, parandalimit të rasteve të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, monitorimit të aktiviteteve të prokurimit publik, hartimin dhe monitorimin e zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit kundër Korrupsionit, hetimin dhe zbulimin e rasteve me natyrë të korrupsionit, mbrojtjen e sinjalizuesve, përpjekjet për parandalimin e fenomenit të korrupsionit si dhe vetëdijesimin e publikut në hapat progresiv drejt krijimit të një shoqërie ku sundon rendi dhe ligji.

Legjislacioni aktual kundër korrupsionit, mbi bazën e të cilit AKK edhe i zhvillon aktivitetet e saj parasheh masat kundër korrupsionit brenda fushës së veprimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit kundër Korrupsionit, veçanërisht në fushën e hetimeve paraprake të korrupsionit, në mbrojtjen e sinjalizuesve, analizimin dhe eliminimin e shkaqeve të korrupsionit, jo pajtueshmërinë mes mbajtjes së posteve publike dhe kryerjes së aktiviteteve fitimprurëse për personat zyrtar, kufizimet në lidhje me pranimin e dhuratave të lidhura me kryerjen e detyrës zyrtare, mbikëqyrjen e pasurive të tyre si dhe të personave në lidhje të afërt me ta dhe kufizimet në lidhje me subjektet kontraktuese që marrin pjesë në tenderët publik.



## V. SITUATA AKTUALE

Kosova ka miratuar legjislacionin relevant në fushën e parandalimit, luftimit dhe hetimit të korrupsionit. Gjithashtu ka të themeluar institucionet relevante me mandat që lidhen me fushën e hetimeve paraprake të korrupsionit, në mbrojtjen e sinjalizuesve, analizimin dhe eliminimin e shkaqeve të korrupsionit, jo pajtueshmërinë mes mbajtjes së posteve publike dhe kryerjes së aktiviteteve fitimprurëse për personat zyrtar, kufizimet në lidhje me pranimin e dhuratave të lidhura me kryerjen e detyrës zyrtare, mbikëqyrjen e pasurive të tyre si dhe të personave në lidhje të afërt me ta dhe kufizimet në lidhje me subjektet kontraktuese që marrin pjesë në tenderët publik.

Pavarësisht kësaj, sipas disa hulumtimeve ndërkombëtare dhe vendore në lidhje me perceptimin e korrupsionit, theksohet se janë bërë shumë pak ndryshime dhe se niveli i korrupsionit ende është shqetësues në Kosovë.

Sipas studimit të UNDP-së "Pulsi Publik për Korrupsionin" i vitit 2019, qytetarët e Kosovës sikurse në maj 2018, të anketuarit e konsiderojnë papunësinë (29.4 për qind), korrupsionin (13.4 për qind) dhe varfërinë (8.6 për qind) si tre çështjet më të mëdha me të cilat ballafaqohet Kosova. Në mënyrë të veçantë, mesatarisht një e katërta e të anketuarve (25 për qind) pohuan që e perceptojnë që korrupsioni në shkallë të gjerë është i pranishëm në institucionet publike dhe ndërkombëtare në Kosovë. Shumica e kosovarëve (68.8 për qind) besojnë se faktorët jo meritore, si lidhjet familjare, ryshfetet, aleancat partiake, miqtë dhe, në një masë më të vogël, pamja dhe gjinia, janë faktorët më të rëndësishëm në sigurimin e punësimit në sektorin publik<sup>1</sup>.

Perceptimet e korrupsionit në shkallë të gjerë ndryshonin nga një përqindje e ulët prej 10.7 për qind e të anketuarve që pohuan se është i përhapur në organizatat ndërkombëtare, deri në nivelin e lartë prej 31.4 për qind të të anketuarve që pohuan se është i përhapur në dogana. Ndërkohë që nivelet e perceptimeve aktuale të korrupsionit në shkallë të gjerë në secilin institucion janë zvogëluar në krahasim me muaji maj 2018, ndryshimet më të mëdha në perceptime janë vërejtur në institucionet vijuese: organizatat ndërkombëtare (10.7 për qind krahasuar me 24.5 për qind në maj), gjykatat (29.1 për qind krahasuar me 38.6 për qind në maj), dhe policia e EULEX-it (20.9 për qind krahasuar me 29.9 për qind në maj). Në përgjithësi, tre institucionet kryesore me më pak korrupsion të perceptuar në shkallë të gjerë janë organizatat ndërkombëtare, institucionet arsimore dhe policia e EULEX-it<sup>2</sup>.

Raportet e Progresit, ndër vite kanë theksuar se Kosova është në një fazë të hershme/ka një nivel përgatitjeje në luftën kundër korrupsionit dhe është arritur pak progres përmes reformave të konsiderueshme legjislative në fushën e zbatimit të ligjit, duke përfshirë edhe Kodin Penal, në hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve të nivelit të lartë, si dhe në ngrirjen

<sup>1</sup> Pulsi Publik XV shkurt 2019, Përpiluar nga UNDP në Kosovë

<sup>2</sup> Po aty, fq 15

paraprake të pasurive. Konfiskimi përfundimtarë i pasurive ende mbetet i ulët.<sup>3</sup> Dispozitat e të drejtës penale mbi korrupsionin janë përgjithësisht në pajtim me standardet relevante evropiane. Kosova nuk është anëtare në shumicën e konventave ndërkombëtare kundër korrupsionit, duke përfshirë Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit, për shkak të çështjeve që lidhen me statusin e saj. Megjithatë, Kosova ka bërë përpjekje të konsiderueshme për të harmonizuar legjislacionin e saj me këto instrumente.

Prandaj, nuk është një surprizë që qytetaret nga Kosova mendojnë se korrupsioni është një nga problemet më të mëdha për vendin. Nga 42 vende pjesëmarrëse në Barometrin Botëror të Korrupsionit 2016<sup>4</sup>, Kosova zuri vendin e tretë me 65% të anketuarve duke pretenduar se korrupsioni është një nga problemet më të mëdha me të cilat ballafaqohet vendi. Vetëm Moldavia me 67% dhe Spanja me 66% ishin të pozicionuar para Kosovës.

Ndërkaq në lidhje me problemet e identifikuar në takimet e grupit punues, sipas raportimeve të bëra nga të gjithë anëtarët e grupit punues, por edhe komenteve të dërguara, si probleme kryesore të identifikuar sipas sektorëve të strategjisë janë si në vijim:

- ⇒ Mungesa e mekanizmave efektiv të kontrollit të brendshëm në fushën e kundër korrupsionit;
- ⇒ Mungesa e auditimit të financave të partive politike;
- ⇒ Mungesa e legjislacionit të duhur për financimin e partive politike, për monitorimin dhe auditimin e financave të tyre;
- ⇒ Mungesa e njësisë përgjegjëse për analiza sektoriale të rrezikut në lidhje me rreziqet nga korrupsionit;
- ⇒ Mungesa e gjobave efektive (administrative) dhe mos forcimi i mekanizmave për parandalimin e konfliktit të interesit;
- ⇒ Mungesa e planeve të integritetit në të gjitha institucionet publike dhe mungesa e institucionit përgjegjës për monitorimin e tij;
- ⇒ Mungesa e kontrollit të ndërmarrjeve publike
- ⇒ Qasja jo e mjaftueshme dhe jo e plotë në dokumentet publike
- ⇒ Problemi i nepotizmit, konfliktit të interesit, politizimit në punësimin në administratën publike
- ⇒ Mos finalizimi i kategorizimit/klasifikimit të vendeve të punës në shërbimin civil;
- ⇒ Mungesa e auditimit të brendshëm dhe menaxhimi jo i duhur i shpenzimeve të të hyrave vetanake të institucioneve publike;
- ⇒ Mos kontrollimi i ndërmarrjeve publike komunale dhe mos vlerësimi i akteve juridike në nivel komunal;
- ⇒ Mos koordinimi i duhur i institucioneve të zbatimit të ligjit;
- ⇒ Mos profilizimi në institucionet e zbatimit të ligjit për rastet e korrupsionit;

<sup>3</sup> Raporti i Progresit për Kosovën 2019

<sup>4</sup> [http://www.transparency.org/whatwedo/publication/people\\_and\\_corruption\\_europe\\_and\\_central\\_asia\\_2016](http://www.transparency.org/whatwedo/publication/people_and_corruption_europe_and_central_asia_2016)

- ⇒ Mungesa e mekanizmit të rishikimit në institucionet e zbatimit të ligjit;
- ⇒ Mungesa e hetimeve financiare paralelisht me hetimet penale.

Të gjitha këto probleme të identifikuar sipas sektorëve, janë adresuar përmes objektivave specifike, me masa dhe aktivitete adekuate të cilat janë paraqitur në Planin e Veprimit të kësaj Strategjie.

## 1. Korniza ligjore

Korniza ligjore bazë në të cilin Agjencia ushtron mandatin e saj ligjor janë aktet e mëposhtme, por jo të kufizuara vetëm në:

### LIGJET:

#### ***Ligji nr. 03/L-159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit***

Ky ligj përcakton statusin dhe përgjegjësitë e AKK-së në fushën e luftimit dhe parandalimit të korrupsionit, veçanërisht në fushën e raportimit, zbulimit dhe hetimit të korrupsionit, zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit kundër Korrupsionit.

#### ***Ligji nr. 04/L-050 për Deklarimin, Origjinën dhe Kontrollin e Pronës së Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Origjinën dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë Personat Zyrtarë dhe Ligjin nr. 04/L-228 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04 / L-050***

Ky ligj përcakton detyrimet e zyrtarëve të lartë publikë për të deklaruar pronën, të ardhurat dhe origjinën e tyre, detyrën e AKK-së për të kontrolluar deklarin dhe kontrollin e pasurisë, si dhe detyrimet e të gjithë personave zyrtarë për të deklaruar dhuratat dhe origjinën e tyre.

#### ***Ligji nr. 06/L -011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik***

Qëllimi i këtij ligji është parandalimi i konfliktit të interesit në interesin publik dhe privat të zyrtarëve të lartë në ushtrimin e funksioneve publike.

#### ***Ligji Nr. 06/L -085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve***

Qëllimi i këtij ligji është mundësimi i sinjalizimit të shkeljeve në sektorin publik dhe privat dhe mbrojtja e sinjalizuesve.

## VI. OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME TË STRATEGJISË

Objektivat e kësaj Strategjie janë si rezultat i nevojës së institucioneve përkatëse shtetërore për të parandaluar dhe luftuar korrupsionin në Kosovë, duke ndërtuar një administratë me integritet më të lartë, përgjegjësi dhe transparencë të plotë. Në të njëjtën kohë, objektivat e strategjisë janë përmirësimi i vazhdueshëm i legjislacionit në luftën kundër korrupsionit dhe promovimin e sundimit të ligjit në Kosovë.

Objektivat e përcaktuara në këtë strategji janë rezultat i kërkesave ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe raportet e botuara nga organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare në fushën e kundër-korrupsionit.

Objektivat kryesore të kësaj Strategjie janë të ndara në këto objektiva horizontale:

- ⇒ Zhvillimi i qasjes “zero tolerancë” ndaj korrupsionit
- ⇒ Ndërtimi i integritetit, përgjegjësisë dhe transparencës në punën e organeve të administratës publike dhe forcimin i besimit të qytetarëve në institucionet publike
- ⇒ Përmirësimi i legjislacionit dhe fuqizimi i kapaciteteve institucionale për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit
- ⇒ Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë në fushën kundër-korrupsioni

### 1. Parimet e përgjithshme të Strategjisë:

Parimet bazë mbi të cilat është hartuar dhe kërkojnë zbatimin e Strategjisë Kundër Korrupsionit janë si më poshtë:

Respektimi i të drejtave të njeriut - ky parim kërkon respektim të pakushtëzuar të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore të njeriut nga të gjitha autoritetet publike dhe t'u mundësojë individëve të drejtat e të cilëve janë shkelur për të kërkuar mjete efektive në baza të barabarta.

Sundimi i ligjit - detyron institucionet të zbatojnë legjislacionin në fuqi pa përjashtim.

Vullneti politik - kërkon nga të gjithë zyrtarët e lartë publikë të demonstrojnë vendosmëri të vërtetë politike për të adresuar në mënyrë efektive problemin e korrupsionit.

Përgjegjësia - obligon të gjitha organet kompetente dhe stafin e tyre që të marrin përgjegjësinë e plotë për veprimet e tyre, duke përfshirë krijimin dhe zbatimin e politikave anti-korrupsion, duke përfshirë zbatimin e kësaj Strategjie dhe Planin përkatës të Veprimit.

Qeverisja e mirë, transparenca dhe integriteti - kërkon që institucionet të vënë të gjitha politikat e tyre në përputhje me zbatimin efektiv dhe efikas të interesit publik; thekson nevojën për institucione të hapura, veçanërisht në lidhje me vendimmarrjen dhe të drejtën e qytetarëve për të pasur qasje në informata publike; kërkon rregulla praktike për respektimin dhe zbatimin e parimeve etike në integritetin institucional dhe personal.

Neutraliteti politik - forcon pavarësinë institucionale, paanshmërinë dhe autonominë e sektorit publik në tërësi, për të funksionuar pa ndikim të jashtëm të panevojshëm.

Menaxhimi i duhur i punëve publike dhe pronës publike - kërkon nga të gjitha institucionet që të menaxhojnë çështjet publike dhe pronën publike në mënyrë efektive dhe efikase dhe vetëm në interesin publik.

Bashkëpunimi - i bën thirrje të gjitha institucioneve përgjegjëse për zbatimin e kësaj Strategjie dhe Plani të Veprimit për të bashkëpunuar në mirëbesim dhe në përputhje me objektivat dhe masat e miratuara, siç thuhet në dokumentet e cekura.

Përfshirja - detyron të gjitha autoritetet publike në Kosovë që të rrisin bashkëpunimin e ngushtë me sektorin privat, shoqërinë civile dhe të gjithë qytetarët në luftën kundër korrupsionit.

Vetëvlerësimi - kërkon vlerësim periodik të rreziqeve të korrupsionit nga institucionet përgjegjëse, me qëllim përmirësimin e zbatimit të kësaj Strategjie dhe Planit përkatës të Veprimit.

## VII. AKTIVITETET DHE ALTERNATIVAT E KONSIDERUARA

Bazuar në përvojën e zbatimit të Strategjive Kombëtare Kundër Korrupsionit (Strategjia Kundër Korrupsionit 2009-2011 dhe Strategjisë Kundër Korrupsionit 2013-2017), në përputhje me ndryshimet në legjislacionin dhe perceptimin e përgjithshëm të publikut në lidhje me korrupsionin në Kosovë gjatë zhvillimit të kësaj Strategjie janë riformuluar, ri-strukturuar dhe analizuar më mirë objektivat strategjike sektoriale dhe aktivitetet dhe janë përgatitur alternativat e mëposhtme. Të gjitha këto janë bërë me qëllim të harmonizimit të përpjekjeve ndërinstitucionale për të luftuar korrupsionin në të gjitha fushat në Kosovë.

Si rezultat, aktivitetet dhe masat e parashikuara për alternativat janë ndarë në këto sektorë:

- ⇒ SEKTORI POLITIK
- ⇒ ADMINISTRATA SHETËRORE DHE QEVERISJA LOKALE
- ⇒ ZBATIMI I LIGJIT DHE GJYQËSORI
- ⇒ PROKURIMI PUBLIK DHE MENAXHIMI I FINANCAVE PUBLIKE

### 1. Sektori politik

Sektori politik vazhdon të jetë fusha më sfiduese në luftën kundër korrupsionit dhe sistemi politik është gjithnjë i shqetësuar nga akuzat për korrupsion. Duhet të forcohet vullneti politik për të shqyrtuar korrupsionin në një mënyrë gjithëpërfshirëse dhe strategjike.

Në nivelin e politikë bërjes duhet të ekzistojë një udhëheqësi për caktimin e agjendës dhe prioritetëve për të përmirësuar rezultatet në luftimin e korrupsionit- në këtë mënyrë të demonstron vullnet politik. Qeveria duhet që përmes Strategjisë kundër korrupsionit dhe me Planin e veprimit, të caktojë prioritetet, të përcaktojë cilat aktivitete duhet të ndërmerren dhe të sigurohet që ato aktivitete të buxhetohen dhe të implementohen në përputhje me planin, për të siguruar rezultate pozitive strategjike gjatë periudhës tri vjeçare. Politika e suksesshme kundër korrupsionit kërkon mbështetje të Qeverisë dhe të opozitës, si dhe duhet të bëhen përpjekje për të siguruar se të gjitha partitë politike janë të përfaqësuara në Kuvend janë të përfshira në diskutime të politikë bërjes kundër korrupsionit dhe idealisht të dakordohen me vizionin e prezantuar për përmirësimin e kornizës së përgjithshme kundër korrupsionit.

Mbikëqyrja parlamentare është një mjet jashtëzakonisht i dobishëm në luftën kundër korrupsionit dhe duhet të forcohet. Ministritë qeveritare, shefat e agjencive dhe zyrtarët tjerë relevant publik duhet të paraqiten rregullisht përpara Kuvendit për t'iu përgjigjur pyetjeve në sesionet e caktuara për tema lidhur me "kundër-korrupsionin" dhe performancën e organeve kundër korrupsionit.

Favorizimi dhe nepotizmi në pozitat e punësuarë në tërë sektorin publik mbetet një shqetësim i madh për publikun dhe për tërë bashkësinë ndërkombëtare. Dëshmia e neglizhencës në punësimin e pozitave paraqitet nga lartë poshtë dhe nga administrata lokale në atë qendrore. Një shqetësim të veçantë paraqesin pretendimet për lidhjet në partitë politike si parakusht për marrjen e posteve dhe vetë partitë politike në negociimin e pozitave të ndjeshme dhe kyçe siç janë emërimet gjyqësore, pozitat menaxhuese dhe të bordeve në ndërmarrjet publike dhe postet e nivelit të lartë të shërbimit publik.

Sistemi i tanishëm për zbulimin e pasurisë dhe të ardhurave të zyrtarëve publik mbetet vetëm i bazuar në letër (dorëzimi i formularëve të pasurisë fizikisht, ende nuk është funksionalizuar sistemi online) dhe lejon mundësi për gabime në plotësim nga zyrtarët që dorëzojnë dhe zyrtarët monitorues në kuadër të Agjencisë kundër korrupsionit. Edhe pse norma e pajtueshmërisë për parashtrësat është shumë e lartë, aftësia për të përdorur këto të dhëna për hetime të hollësishme në pasuri të pashpjegueshme është e papërfillshme.

Në fushën e parandalimit të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik ka një përparim të dukshëm, por ka akoma punë për tu bërë, e të cilat janë pjesë e kësaj strategjie të veprimit.

Ligji i ri për Parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, i hyrë në fuqi në vitin 2018 ka bërë një avancim në kuptim të asaj që ka bërë kufizimin e angazhimeve të shumëfishta për zyrtarë të lartë publik, e po ashtu ka lënë në përgjegjësi të institucioneve publike individuale që të hartojnë rregullativë të posaçme për parandalimin e konfliktit të interesit brenda institucioneve të tyre përkatëse.

Pra, ajo që duhet të jetë pjesë e kësaj strategjie është obligimi i institucioneve të vendit që të hartojnë rregullativë për Parandalimin e konfliktit të interesit nëpër të gjitha institucionet e tyre publike, gjithnjë duke u bazuar në Ligjin për Parandalimin e konfliktit të interesit.

Po ashtu obligimi i institucioneve publike është dhe mbetet krijimi, funksionalizimi dhe fuqizimi i autoriteteve përgjegjëse për parandalimin e konfliktit të interesit nëpër të gjitha institucionet publike të vendit konform kërkesave të Agjencisë kundër Korrupsionit në bashkëpunim të vazhdueshëm me divizionin për Autoritete përgjegjëse brenda Agjencisë kundër Korrupsionit.

Financimi i partive politike mbetet një fushë shumë e ndjeshme e prirur për abuzime. Aktualisht, financimi i partive politike është hendeuku i vetëm më i madh në sistemin e anti-korrupsionit. Ekziston mungesë serioze e transparencës kur bëhet fjalë për resurset financiare dhe deklaratat e partive politike si dhe zbatimin e dispozitave ligjore ekzistuese. Duke pasur parasysh marrëdhëniet kundërshtuese në mes të partive politike dhe financimin e paligjshëm, financimi i partive politike duhet të rregullohet me standarde të qarta dhe të parashikuara përmes përdorimit të kontrollit të fortë dhe mekanizmave zbatuese. Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ) i Kosovës është autoriteti përgjegjës për marrjen dhe kontrollimin formal të raporteve financiare nga partitë politike. Sipas shënimeve, raportet financiare të paraqitura

zakonisht nuk përputhen me rregulloret e definuara me ligj. Një ndryshim në Ligjin për financimin e partive politike i aprovuar në vitin 2013, ka transferuar përgjegjësinë për auditimin e entiteteve politike nga KQZ të Kuvendi i Kosovës. Edhe pse KQZ në të kaluarën është përballur me sfida të mëdha në kryerjen e përgjegjësisë të auditimit për shkak të mungesës së resurseve njerëzore dhe financiare, raportet e auditimit u bënë të qasshme për publikun për vitet 2011 dhe 2012.

Me transferimin e përgjegjësisë në Kuvendin e Kosovës në vitin 2013, për shkak të mungesës së stabilitetit institucional dhe vullnetit politik, Kuvendi nuk ia arriti të angazhojë auditorë për të bërë auditimin e deklaratave financiare vjetore të partive politike për tre vjetët e fundit dhe shpenzimet gjatë zgjedhjeve nacionale dhe lokale për vitet 2013 dhe 2014, dhe për zgjedhjet kombëtare dhe lokale për vitin 2017. Kjo situatë duket se qartë tregon një nivel të ulët të vullnetit politik për rritjen e transparencës së financimit të partive politike nga ana e partive politike. Sistemi i cili përcakton përgjegjësinë për auditimin e financave të partive politike për përfaqësuesit e partisë politike të njëjtë që përfiton nga ato fonde, drejtpërdrejtë paraqet konflikt interesi dhe iu dorëzohet rrezikut potencial sa i përket transparencës dhe përgjegjshmërisë së tërë sistemit politik.

Megjithatë, versioni i fundit i projektligjit që është sjellë në Kuvend përbën një hap të madh në avancimin e transparencës dhe llogaridhënies financiare të subjekteve politike karshi publikut, me theks të veçantë te kontrolli i financimit të subjekteve politike, auditimit të raporteve financiare dhe publikimi i tyre. Gjithashtu me projektligj përcaktohen edhe masat ndëshkuese për subjektet që nuk respektojnë kërkesat e dala nga ky ligj. Miratimi i këtij projektligji, reflekton edhe opinionin e Komisionit të Venedikut.



## 2. Administrata Publike

Disa përmirësime janë bërë në transparencën e shpenzimit, rekrutimit dhe dhënien e tenderëve nga ana e institucioneve publike edhe në nivelin lokal dhe në nivelin qendror, me një numër të institucioneve që publikojnë shpenzimet e veta. Me gjithë këtë, kjo praktikë nuk përdoret njësoj nëpër institucionet komunale dhe të nivelit qendror. Procedurat e verifikimit mungojnë në mënyrë të dukshme. Kodet e mirësjelljes ekzistojnë në disa institucione, megjithëkëtë ato rrallë diskutohen në mesin e personelit dhe shumë zyrtarë civil nuk kanë njohuri për ato. Nuk ekzistojnë procedura formale për bashkëpunëtorët për të raportuar sjelljet jo etike dhe ekziston frika nga ndëshkimi.

Në Strategjinë e mëparshme, aprovimi i planit të integritetit për institucionet publike u aplikua si masë. Ky mjet është një metodë shumë e dobishme për institucionet për të identifikuar rreziqet e korrupsionit dhe për zhvillimin e planeve të lehtësimit për minimizimin e këtyre rreziqeve të ngjashme. Deri më sot, disa institucione kanë kompletuar planet e integritetit, prej tyre disa janë institucione komunale dhe disa të tjera janë institucione të nivelit qendror. Sistemi do të përfitonte shumë nga aprovimi i kriterëve të qarta se kush duhet të aprovojë një plan të integritetit, çka përmbajnë planet e tilla dhe mandatin e institucionit publik për të bërë monitorim të duhur.

### 3. Zbatimi i ligjit dhe gjyqësorit

Sundimi i Ligjit dhe reformat juridike janë ndër kërkesat kryesore në luftën kundër korrupsionit dhe fenomeneve tjera negative në Kosovë dhe mbetet prioriteti kryesor në mënyrë që të arrihet një evidencë e veprave penale të korrupsionit të ndjekura me sukses.

Politikanët shpesh kanë hedhur poshtë perceptimin e publikut për korrupsionin e përhapur dhe e hedhin poshtë duke e kthyer në statistika zyrtare, ku numri i akuzave për vepra penale të korrupsionit është relativisht i ulët. Duke argumentuar kështu se perceptimi i korrupsionit është një ekzagjerim i madh dhe nuk reflekton realitetin. Në të vërtetë, të dhënat statistikore të rasteve gjyqësore tregojnë se rastet e korrupsionit nuk shfaqen në pesë kategoritë e trajtuara nga sistemi i drejtësisë në Kosovë. Në vitin 2015, nga 20,077 raste penale të trajtuara nga gjykatat e Kosovës, vetëm 200 ose pak më pak se 1% ishin shkeljet e korrupsionit, ndërsa më shumë ose më pak e njëjta prirje u përsërit në vitin 2016: nga 23,766 raste penale vetëm 284 raste të korrupsionit, ose më pak se 1.2%. Ky model ka vazhduar edhe në vitin 2017; nga janari deri në qershor ka pasur 12,680 lëndë penale të vendosura në gjykatat e përgjithshme të Kosovës, ndërsa vetëm 151 raste kanë qenë raste të korrupsionit ose pak më pak se 1,2%. Edhe më shumë, nga këto 151 raste nuk ka pasur asnjë rast që rrjedh nga Mekanizmi Ndjekës. Prandaj, duhet të bëhen përpjekje për të rritur numrin e rasteve të përgjithshme, si dhe numrin e rasteve komplekse që përfshijnë shuma të mëdha parash dhe asetesh që thuhet se janë vjedhur.

Prokuroria e Shtetit të Kosovës ka prokurorë të specializuar të krimit ekonomik të cilët punojnë së bashku me hetues të specializuar nga Policia e Kosovës për veprat penale të korrupsionit. Prokurori i Shtetit (PSH) gjatë vitit 2019 ka pasur në punë gjithsejtë 166,633 kallëzime – lëndë penale (lëndë nga regjistrat: PP, PPM, PPN, NJN, PPP, lëndët e PA-së dhe ZKPSH-së). Nga ky numër i lëndëve: - 111,340 ose 66.81 % janë të trashëguara/bartura si lëndë të pazgjidhura nga vitet paraprake, dhe - 55,293 ose 33.19 % janë pranuar në punë gjatë vitit 2019. Gjatë këtij viti, nga ky numër i lëndëve: - 79,675 se 47.81%<sup>2</sup> e lëndëve në punë gjatë vitit 2019 janë zgjidhur apo proceduar në organet kompetente dhe - 86,958 ose 52.19 % e të gjitha lëndëve në punë kanë mbetur pa u zgjidhur. Efikasiteti i lëndëve të zgjidhura gjatë vitit 2019 është: - 79,675 kallëzime – lëndë penale janë zgjidhur gjithsej; - 24,382 kallëzime – lëndë penale më shumë se që janë pranuar gjatë vitit, apo 44.09% kallëzime – lëndë penale më shumë se që janë pranuar gjatë vitit.<sup>5</sup>

Ekipet e përbashkëta të hetimit, të udhëhequra nga prokurorët dhe që bashkëpunojnë me organet e zbatimit të ligjit, Njësia e Inteligjencës Financiare, Administrata Tatimore, zyrtarët e doganave dhe të tjerët përdoren herë pas here, por nuk janë përdorur për të hetuar një rast të tërë nga fillimi në fund. Gjithashtu, ekipet e përbashkëta hetimore dhe përdorimi i teknikave të veçanta hetimore duhet të shfrytëzohen më mirë. Mjetet dhe format e zbulimit të deklarimit të pasurisë që mbahen nga Agjencia Kundër Korrupsionit konsultohen rregullisht

<sup>5</sup> Raporti Vjetor i Punës nga Këshilli Prokurorial i Kosovës - <https://prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/Dokumente%20Publikime/KPK/Raporte/Keshilli%20Prokurorial%20i%20Kosov%C3%ABs%20-%20Raporti%20vjetor%202019.pdf>

nga autoritetet hetuese dhe shumë raste sjellin vëmendjen e tyre nga Agjencia, megjithatë asnjë nga këto ankesa kriminale nuk ka rezultuar me ndjekje penale të suksesshme. Njësia e Inteligjencës Financiare monitoron personat e ekspozuar politikisht (PEP) vendas dhe ndërkombëtar në bazë të raporteve të dyshimta të veprimtarisë dhe raporteve të transaksioneve të dyshimta që merr nga subjektet raportuese.

Një numër i madh i lirimeve dhe ndryshimeve në rastet e korrupsionit dhe krimit financiar sugjerojnë se duhet të bëhet më shumë punë me gjyqësorin për të shpjeguar rastet komplekse financiare. Gjithashtu, nevojitet një koordinim më i mirë midis organeve të parandalimit dhe eliminimit, veçanërisht në përmirësimin e cilësisë së ankesave kriminale të parashtruara nga organet parandaluese në mënyrë që ato të bëhen më vepruese nga policia dhe prokuroria. Gjyqësori duhet gjithashtu të merret më shumë me rastet financiare në mënyrë që të kuptojë se si autoritetet hetuese mbledhin dëshmi dhe si funksionojnë ndërmarrjet kriminale financiare në mënyrë që të merren me numrin e madh të shfajësimeve në raste të tilla. Specializimi i rritur nga ana e prokurorisë dhe policisë mbi hetimin e krimit financiar, sekuestrimin e pasurisë dhe në fusha të tilla të avancuara si ekzaminimi i mashtrimit dhe llogaridhënia forenzike do të ishte jashtëzakonisht i dobishëm. Nevojitet koordinimi më i mirë midis organeve parandaluese dhe hetuese dhe trajnimi i organeve parandaluese se si të paraqiten të dhëna të dobishme.

#### 4. Prokurimi Publik dhe Menaxhimi i Financave Publike

Zyra Kombëtare e Auditimit, ka kryer auditime të Institucioneve publike, duke identifikuar parregullsi dhe ka publikuar vazhdimisht gjetjet me rekomandime. Sipas opinionit të Auditorit të Përgjithshëm, Pasqyrat Financiare Vjetore të Qeverisë për vitin 2019 paraqesin pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale. Përgatitja e buxhetit për vite me radhë vazhdon të mbetet një nga sfidat kryesore të Qeverisë. Analizat nga rishikimet tona shpalosin mospërputhje domethënëse në mes planifikimit të pranimeve buxhetore dhe shumave aktuale të këtyre pranimeve. Shuma aktuale e pranimeve në fund të vitit ishte për 258 milionë më e ulët sesa pranimet e parashikuara me buxhet final, apo realizimi kundrejt planifikimit ishte 89.6%. Situatë e njëjtë lidhur me planifikimet buxhetore ishte edhe gjatë vitit paraprak. Ndërsa, sa i përket planifikimit të shpenzimeve, ato sipas buxhetit final ishin projektuar me një deficit buxhetor prej rreth 37 milionë euro, por ky projeksion nuk ishte realizuar, dhe në fund të vitit shuma totale e pranimeve ishte shpenzuar në shkallën prej 96.8%.<sup>6</sup>

Rezultatet e auditimit shpalosin se raportimi financiar i 14 ndërmarrjeve të audituara ka mangësi dhe është i pasaktë. Për këtë arsye për 13 ndërmarrje është dhënë opinion negativ, dhe vetëm një prej tyre ka opinion pozitiv. Përveç raportimit të dobët, gjendja e tyre financiare është e vështirë dhe struktura e financimit është mjaft e pavolitshme. Nga pasqyrat financiare për vitin 2019, shihet se gjashtë ndërmarrje publike kishin operuar me humbje, që në total kapë shumën prej rreth 28 milionë, ndërsa tetë ndërmarrjet tjera kishin prezantuar rezultat pozitiv financiar, me fitim simbolik prej më pak se 1,3 milionë.

Rekomandimet e dhëna në vitin paraprak janë adresuar vetëm pjesërisht. Prej numrit të përgjithshëm të rekomandimeve të dhëna (921), plotësisht ishin zbatuar 370 ose 40%, në proces të zbatimit ishin 113 apo 12%, nuk ishin adresuar 312 apo 34% dhe 126 apo 14% ishin mbyllur të pa zbatuara.

Korniza ligjore është kryesisht e vendosur. Sistemi i prokurimeve publike është kryesisht transparent dhe i qasshëm për publikun. Organi Shqyrtues i Prokurimit ka kompetenca që të shqyrtojë dhe të diskualifikojë ofertuesit nga pjesëmarrja në prokurim publik për një periudhë njëvjeçare për dërgimin e informacioneve të rrejshme ose për falsifikimin e dokumenteve.

Vendet e lira të paplotësuara në Bordin e Shqyrtues i Prokurimit pengojnë punën e tij duke stërzgatur aktivitetet e prokurimit dhe kështu rritur numrin e ankesave.

Rregullimi i bazës ligjore dhe mekanizmave për trajtimin e konfliktit të interesit në procedurat e shqyrtimi të ankesave në OSHP, jep hapësirë për situata të mundshme të konfliktit të interesit dhe mos transparencën në përzgjedhjen e ekspertëve të prokurimit publik për trajtimin e ankesave në OSHP. Për këtë, nevojitet transparencë më e madhe dhe mekanizma të forcuara të brendshme të parandalimit të konfliktit të interesit.

Të gjitha autoritetet kontraktuese duhet të paraqesin njoftime për oferta, të cilat pastaj publikohen në faqen e internetit të Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik. Konflikt i interesit i ofertuesve dhe autoriteteve kontraktuese rregullohet me Ligjin për prokurimet publike dhe

<sup>6</sup> Raporti i Auditimit për vitin 2019: [http://www.zka-rks.org/wp-content/uploads/2020/09/RaportiVjetor\\_Broshura\\_Final.pdf](http://www.zka-rks.org/wp-content/uploads/2020/09/RaportiVjetor_Broshura_Final.pdf)

ndalon pjesëmarrjen në tender për çdo person i cili është dënua në gjykatë për mashtrim ose për akt korruptiv, për dhjetë vjet. “Ndikimi i paligjshëm” i procedurës së prokurimit publik rregullohet me Ligjin për Prokurimin publik. Faqja e internetit të prokurimeve publike është e qasshme publikisht dhe mund të bëhen kërkime. Faqja e internetit përfshin këto informacione: Njoftim paraprak, njoftim kontraktues, njoftim për fitimin e kontratës, njoftim për ndërprerjen e aktiviteteve të prokurimit, emrat e fituesve të tenderit.

Në vazhdim, aplikohet edhe sistemi i e-prokurimit, që ka rritur transparencën më tepër, siç është bërë centralizimi i prokurimit. Lista e zezë për ofertuesit të cilët janë zënë në shkelje të Ligjit të prokurimit publik nuk është funksionale ose nuk përdoret.

Agjencia kundër korrupsionit është gjithashtu e përfshirë në monitorimin e procedurave të prokurimeve publike për konflikt interes potencial dhe jep mendime për rastet e përzgjedhura. Agjencia merr informacione rreth pretendimeve të korrupsionit ose konflikt interesit nga ofertuesit dhe pas shqyrtimit dhe duke konkluduar se ekzistojnë informacione të mjaftueshme për dyshim të arsyeshëm se mund të ketë ndodhur shkelje penale, ky informacion dërgohet në zyrën e prokurorit. Gjatë viteve të kaluara, opinionet e nxjerra nga Agjencia pjesërisht janë zbatuar.

Në të kaluarën është sfiduar mandati i institucioneve përgjegjëse për prokurimin publik, duke aluduar në mbivendosje të kompetencave. Sidoqoftë, korniza ligjore është përmirësuar dhe tani është i qartë roli i AKK, OSHP-së, KRPP-së, Autoritetit Kontaktues në fushën e prokurimit publik. Kjo ka rezultuar që të ketë një bashkëpunim më të mirë të institucioneve të lartë përmendura. Shqetësuese mbetet mungesa e monitorimit adekuat të implementimit të kontratave të ndara dhe përmbajtja e anekseve të kontratave.

Përderisa është rritur transparenca në prokurimin publik dhe menaxhimin e financave publike, një gjë e tillë nuk është arritur me zbulimin e mashtrimit, posaçërisht nga ana e zyrtarëve të lartë publik. Duhet të forcohen përpjekjet për të siguruar se parregullsitë e identifikuar janë hetuar në mënyrë adekuate nga policia dhe prokurorët.

Evazioni fiskal, mashtrimet tatimore dhe ekonomia e zezë vazhdojnë të përbëjnë rreziqe të mëdha. Mungesa e mbledhjes së taksave heq të ardhurat e nevojshme për buxhetin dhe kur bashkohet me pretendime të korrupsionit, shkatërron besimin e qytetarëve ndaj qeverisë.

## VIII. SFIDAT PËR ARRITJEN E OBJEKTIVAVE STRATEGJIKE

*Mungesa e vullnetit politik për ndryshimet e nevojshme:* pa vullnet real dhe të vërtetë politik dhe mbështetje të fortë dhe të prekshme për të gjitha organizatat e përfshira, nuk do të ketë ndryshime në luftën legislative, institucionale dhe praktike kundër korrupsionit.

*Mungesa e ndërgjegjësimit dhe njohurive mbi ekzistencën e Strategjisë dhe karakteristikat themelore të saj:* nëse organizatat e synuara në vend nuk kanë njohuri për ekzistencën e Strategjisë Kundër Korrupsionit dhe detyrat e tyre kryesore të përshkruara në strategji, ato nuk mund ta zbatojnë atë.

*Mungesa e monitorimit efektiv të zbatimit:* monitorimi efektiv i mundëson organizatave të synuara të ndjekin arritjet e tyre, por edhe organet monitoruese për të kontrolluar, koordinuar dhe përmirësuar nivelin e zbatimit.

*Zbatimi i dobët i Strategjisë:* mungesa e arsyeve të justifikuara dhe të pajustificuara që pengojnë zbatimin efektiv të Strategjisë, organizatat e synuara duhet të kuptojnë se asnjë arsye nuk është mjaft e fortë për të shërbyer si justifikim për mos zbatimin e strategjisë.

*Nuk ka llogaridhënie për zbatimin e dobët të sektorit publik:* organizatat dhe individët nga sektori publik që nuk e kuptojnë se strategjia kundër korrupsionit dhe plani i saj i veprimit duhet të zbatohen, duhet të kuptojnë se ato janë të arsyeshme për ta bërë këtë dhe do të ekspozohen për sanksione në rast të shmangies së përgjegjësive të tyre.

*Mungesa e interesit për zbatim në sektorin privat dhe në shoqërinë civile:* sektori privat dhe organizatat e shoqërisë civile nuk mund të detyrohen të zbatojnë Strategjinë, prandaj ato duhet të motivohen nga cilësia e zgjidhjeve të përcaktuar në objektivat, masat dhe aktivitetet e Strategjisë dhe Planit të veprimit.

## IX. QASJA E REKOMANDUAR

Zhvillimi i Strategjisë dhe përcaktimi i objektivave të saj është bërë duke marrë parasysh të gjithë faktorët relevantë. Në këtë drejtim, janë marrë parasysh mundësitë buxhetore, kapacitetet personale dhe profesionale të institucioneve zbatuese të kësaj Strategjie. Për më tepër, objektivat dhe aktivitetet janë përcaktuar pas hulumtimeve dhe takimeve të mbajtura me pjesëmarrës të ndryshëm të zbatimit dhe sundimit të ligjit, përfaqësuesve të shoqërisë civile dhe medias.

Zbatimi i aktiviteteve të përcaktuara nënkupton financat, të cilat janë përcaktuar në detaje në kuadër të Planit të Veprimit. Në aspektin e shtetit, luftimi dhe parandalimi i korrupsionit ndikon në përmirësimin e imazhit të Kosovës, përkatësisht, duke përfunduar gjetjet në Raportin e Progresit të Komisionit Evropian dhe raporte të tjera të përgatitura nga organizatat vendore dhe ndërkombëtare.

Dështimi për të vepruar dhe zbatuar strategjinë rrezikon funksionimin e sistemit të sundimit të ligjit në Kosovë, të ndërhyrjes jo shtetërore kundër një aktiviteti të dëmshëm.

Kjo strategji përcakton masat konkrete dhe aktivitetet e hollësishme të agjencive zbatuese në objektivat dhe aktivitetet pjesore, përkatësisht përshkruan edhe afatet kohore për zbatimin e tij

## X. ZBATIMI, MONITORIMI DHE VLERËSIMI I STRATEGJISË

Zbatimi i Strategjisë duhet të monitorohet rregullisht dhe duhet të rregullohet me ligj. Prandaj, të gjitha organizatat që u është caktuar një detyrë për të zbatuar të paktën një pjesë të planit përkatës të veprimit, do të kërkohet që të raportojnë për zbatimin në baza vjetore. Në rast të vonesave në raportim, do të aplikohen të gjitha masat e përcaktuara në dispozitat ligjore që mbulojnë shërbimin civil, duke filluar nga Ligji për Shërbimin Civil, Kodi i Etikës, Ligji i Punës, Rregulloret e brendshme të institucioneve gjegjëse dhe dispozitat tjera të ligjeve pozitive në Kosovë.

### 1. Roli i sistemit të monitorimit

Procesi i zbatimit të Strategjisë do të jetë proces i realizimit të objektivave strategjike, objektivave specifike si dhe aktiviteteve. Monitorimi dhe vlerësimi i realizimit të objektivave dhe efikasitetit të aktiviteteve relevante janë pjesë përbërëse e strategjisë dhe komponentëve kryesorë të procesit të zbatimit të tij. Monitorimi dhe vlerësimi do të ndihmojnë në përcjelljen e zbatimit të strategjisë, për të matur nivelin e realizimit të objektivave të tij në proces, për të vlerësuar nevojën për ndryshime dhe për të përcaktuar ndryshimet, veçanërisht në lidhje me aktivitetet.

Procesi i monitorimit do të realizohet nëpërmjet institucioneve të përgjegjshme, përmes Agjencisë Kundër Korrupsionit me pjesëmarrje të gjerë të palëve të interesuara. Dimensionet kryesore të monitorimit dhe vlerësimit të Strategjisë janë:

- Kapacitetet institucionale;
- Treguesit e monitorimit gjatë zbatimit dhe deri në fund të periudhës
- Burimet e informacionit dhe instrumentet matëse;
- Shpërndarja dhe përdorimi i rezultateve të monitorimit dhe vlerësimit.

### 2. Kapacitetet institucionale për monitorim dhe vlerësim

Sistemi i monitorimit dhe vlerësimit do të shtrihet në të gjitha institucionet përgjegjëse për realizimin e objektivave të përcaktuara në strategjinë dhe planin e veprimit.

AKK përmes Divizionit për Hetim dhe Strategji do të jetë bartësi kryesor dhe përgjegjës për arritjen e objektivave. Divizioni për Hetim dhe Strategji i AKK-së do të monitorojë treguesit më të rëndësishëm që merren me strategjinë. Në fund të çdo viti, duhet të përgatisë një raport profesional mbi nivelin e arritjes së objektivave që do t'i paraqiten Drejtorit të AKK-së dhe se do t'i dorëzohet Kuvendit të Kosovës.

Ministritë përkatëse, nëpërmjet pikave të kontaktit dhe institucioneve të tjera lokale përgjegjëse për zbatimin e kësaj strategjie, do të jenë përgjegjës për monitorimin dhe



vlërësimin e aktiviteteve që ata kanë si mbajtës, duke përfshirë prokurorët dhe gjykatat. Këto institucione do të informojnë në mënyrë periodike AKK në Divizionin për Hetimin dhe Strategji, në mënyrë që raportet të jenë të unifikuara dhe një raport vjetor përgatitet në bazë të këtyre raporteve.

Organizatat joqeveritare, shoqëria civile dhe mediat do të marrin pjesë në monitorimin dhe vlerësimin e Strategjisë në tryeza të përbashkëta që do të organizohen nga AKK. Në këto tryeza të rrumbullakëta, shoqëria civile do të paraqesë raporte vëzhgimi lidhur me projektet dhe programet që ata kanë zbatuar.

Sipas konventave ndërkombëtare, vendet duhet të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën dhe me organizatat përkatëse ndërkombëtare dhe rajonale në promovimin dhe zhvillimin e strategjive anti-korrupsion. Strategjia kundër Korrupsionit do të publikohet dhe do të jetë e arritshme për publikun vendor dhe ndërkombëtar dhe institucionet anti-korrupsion në Kosovë do të jenë të hapura për bashkëpunim me vendet dhe institucionet e tjera në rajon dhe në mbarë botën. Bashkëpunimi do të përfshijë kryesisht fusha të tilla si shkëmbimi i informacionit, shkëmbimi i praktikave të mira, harmonizimi i temave me interes të përbashkët dhe organizimi i ngjarjeve që synojnë rritjen e shkathtësive të këtyre vendeve dhe institucioneve në lidhje me hartimin efektiv dhe zbatimin e strategjive kundër korrupsionit.

### **3. Shpërndarja dhe përdorimi i rezultateve të monitorimit dhe vlerësimit**

Rezultatet e monitorimit dhe vlerësimit do të shpërndahen për të informuar publikun për progresin e bërë në avancimin e të drejtave intelektuale, përkatësisht arritjen e objektivave strategjike. Pas hartimit të raporteve të progresit, bazuar në të dhënat dhe sondazhet, ato do të shpërndahen midis përdoruesve, të cilat janë:

- Institucionet shtetërore,
- Partnerët ndërkombëtarë,
- Shoqëria civile,
- Media,
- Publiku i gjerë.

Institucioni kryesor përgjegjës për shpërndarjen e rezultateve është AKK, respektivisht Divizioni për Hetim dhe Strategji. Publikimi i rezultateve do të bëhet përmes mediave ose nëpërmjet organizimit të seminareve dhe tryezave të rrumbullakëta, në përfundime rreth progresit të strategjisë.

## XI. PLANI I VEPRIMIT

Plani i Veprimit është zhvilluar brenda kuadrit të përgjithshëm strategjik të përcaktuar në Strategjinë Shtetërore të Republikës së Kosovës. Plani i Veprimit është në raport me kornizën e përgjithshme të Strategjisë dhe ka përmbajtjen e mëposhtme:

- Objektivat strategjike; Masat strategjike;
- Aktivitete konkrete për realizimin e objektivave dhe masave strategjike;
- Institucionet përgjegjëse dhe mbështetëse për arritjen e çdo qëllimi dhe aktiviteti;
- Afati kohor për realizimin e secilit objektivi;
- Burimet e domosdoshme financiare për zhvillimin e aktiviteteve;

Treguesit për realizimin e secilit objektivi dhe aktivitet. Plani i Veprimit është planifikuar të rishikohet në baza vjetore nën mandatin e Agjencisë Kundër Korrupsionit, sidoqoftë, ndryshimi dhe plotësimi i tij mund të bëhet edhe më herët varësisht nga situatat dhe nevojat e paraqitura për ndryshimin dhe plotësimin e tij. Azhurnimi i Planit të Veprimit do të bëhet përmes rishikimit, përmes një manuali të punës dhe do të përkthehet në një dokument të veçantë.

## **XII. PRIORITETET DHE PËRGJEGJËSITË**

Qeveria e Republikës së Kosovës do të obligojë të gjitha institucionet relevante që janë cekur si pjesëmarrës në këtë dokument për të planifikuar në mënyrë të duhur zbatimin e masave të përmendura në planet e tyre afatmesme dhe afatgjata, duke përcaktuar prioritetet dhe institucionet përgjegjëse gjatë pesë viteve të kësaj periudhë strategjike siç përcaktohet në Planin e Veprimit.